



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:048423
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05279470

CAP.nr.920/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbaremore kreditorit R.A.R., nga Prishtina, e përfaqësuar me autorizim nga L.B.Y., avokate në Prishtinë, ndaj debitorit SHSKUK, në Prishtinë, objekt i përmbaremit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.91/2022 të datës 27.03.2023, me datë 02.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet e themeltë ankesa e kreditorit R.A.R., nga Prishtina, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.91/2022 të datës 27.03.2023, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.91/2022 të datës 27.03.2023, në dispozitiv e ka refuzuar propozimin për lejimin e përmbaremit të kreditorit R.A.R., nga Prishtina, i ushtruar në këtë gjykatë me datë 18.02.2022, si i pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e autorizuar e kreditorit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbaremore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të prish aktvendimin ankimor dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimi i atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbartimit, në gjykatën e shkallës së parë me datë 18.02.2022, ka ushtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit përmbartues - Vendimit të Inspektoratit të Punës me numër 01Nr.XX-XX/XX i dt.13.03.2020, mbi bazën e të cilit ka kërkuar që të lejohet përmbartimi i vendimit fjalë ashtu që të detyrohet debitori t'ia paguaj kreditorit kompensimin e një page jubilarë. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, me aktvendimin e atakuar e ka refuzuar propozimin për lejimin e përmbartimit, me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është propozuar që të iniciohet procedura përmbartimore konform nenit 22 dhe 36 të LPP-së, edhe pse përbën titull ekzekutiv - dokument përmbartimor, i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbartim, sepse gjykata konstatoi se dokumenti përmbartues nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, siç përcaktohet me nenin 36 të LPP-së, nuk është i plotfuqishëm dhe i përmbartueshëm. Vendimin e ka bazuar në nenin 3.4 dhe 44.3 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 të LPK-së, lidhur me nenin 29, paragrafi 1.3 dhe 27 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të procedurës përmbartimore kur ka refuzuar propozimin për lejimin e përmbartimit, duke u bazuar në dispozitën e nenit 36, paragrafi 1, të LPP-së, me arsyetimin se dokumenti përmbartimor nuk e përmban klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri. Gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerëson nëse dokumenti i dhënë në procedurë administrative Vendimit të Inspektoratit të Punës me numër 01Nr.XX-XX/XX i dt.13.03.2020, i plotëson kushtet ligjore nga neni 22 par.2, nënpar. 1.2 të LPP-së, që përcaktohet si dokument përmbartues, e pastaj të vlerësoj se dokumenti i dhënë në procedurë administrative a është i përshtatshëm për përmbartim sipas nenit 27 par.1 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk e ka marrë parasysht nenin 6.4 të Ligjit Nr.2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, i cili është i përmbartur në vendimin administrativ, duke qenë se me nenin 24 par.3 të LPP-së është e përcaktuar se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Andaj, nga të cekurat u deshtë që ky aktvendim të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara me lartë, të vlerësoj dokumentin përmbartimor në bazë të cilit kreditori ka ushtruar propozim për përmbartim, nëse i plotëson kushtet formale juridike për të qenë dokument përmbartues sipas nenit 22 i LPP-së, dhe pastaj të vlerësoj se dokumenti i dhënë në procedurë administrative a është i përshtatshëm për përmbartim sipas nenit 27 par.1 të LPP-së, e pas kësaj të vazhdoj procedurën konform dispozitave ligjore duke marr aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.920/2023, me datë 02.02.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti